

RAPORT I MONITORIMIT TË PROKURIMIT NË KOMUNËN E PRIZRENIT

‘Restaurimi i objekteve kulturore në Prizren’

Hulumtues: Eroll Shabani (EC), Agim Cena (EC), Naim Cahani (KDI)

Fasilitatore: Diana Metushi-Krasniqi

Gusht 2021, Prizren

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	2
HYRJA	3
GJETJET KRYESORE	3
METODOLOGJIA	4
ANALIZA E KONTRATËS	4
KONKLuzion.....	6
REKOMANDIME.....	7

LISTA E SHKURTESAVE

BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
DES	Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri
DUPH	Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
OE	Operatori Ekonomik
QRTK	Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë
THV	Të hyrat vetanake

HYRJA

Historia kulturore sjell në jetë një kohë dhe vend të kaluar. "Kultura" gjithashtu mund të nënkuptojë qëndrimet, vlerat, supozimet dhe paragjykimet e përditshme, si dhe ritualet dhe praktikën që i shprehin ato nga besimet magjike të rolet gjinore dhe hierarkitë racore. Në këtë kuptim, instinktet, mendimet dhe veprimet tona kanë një prejardhje të cilën historia kulturore mund ta ndriçojë dhe shqyrtojë në mënyrë kritike. Historia kulturore është një përpjekje për të banuar në mendjet e njerëzve të botëve të ndryshme. Ky udhëtim, si letërsi e madhe, është emocionues në vetvete. Ajo është gjithashtu tejet e çmueshme për të rimenduar dhe rindërtuar momentin tonë historik.

Ashtu si ajri që thithim, konteksti kulturor që formon kuptimin tonë për botën është shpesh i padukshëm për ata që janë të rrethuar prej tij; historia kulturore na lejon të bëjmë një hap prapa dhe të pranojmë se disa nga ato që ne i marrim si të mirëqena janë të jashtëzakonshme dhe se disa nga ato që ne kemi menduar të pandryshueshme dhe të natyrshme janë të kushtëzuara dhe të hapura për të ndryshuar.

Kjo është pse Prizreni, jo veç që njihet si kryeqyteti i kulturës së Kosovës, dhe ndjell turizëm të vazhdueshëm, por pse Prizreni jep një ndjesi dhe qetësi shpirtërore ndryshe nga qytetet tjera në Kosovë. Konservimi, ruajtja dhe vazhdimi i bartjes së trashëgimisë kulturore dhe historike që ofron ky qytet nuk është i rëndësishëm vetëm për qytetarët e Prizrenit, por i gjithë Kosovës. Prandaj, edhe rëndësia e investimeve të vazhdueshme në ruajtjen e këtij thesari kombëtar është i një rëndësie tejet të lartë.

Ndonëse kjo është e njohur edhe nga politikat shtetërore të Kosovës, e cila çdo vit alokon rreth tre milion euro për restaurimin dhe konservimin e kësaj trashëgimie, gjendja në terren flet ndryshe. Objektet e vjetra, e veçmas ato që janë prona private, ndonëse të mbrojtura me ligj dhe në strategji të investimeve, po vazhdojnë të degradohen çdo ditë e më shumë në mungesë të kujdesit dhe mirëmbajtjes adekuate. Ato, po bëhen edhe një rrezik për shoqërinë duke rrezikuar shembjen, e disa që restaurohen, prej tyre ka që nuk ngjajnë më në objekte të trashëgimisë kulturore e historike.

Hulumtime të ndryshme të shoqërisë civile si dhe raportet e mediave për dukurinë e ndërtimeve pa leje dhe rrënimet posaçërisht në Qendrën Historike të Prizrenit e bëjnë edhe më të theksuar nevojën që këto investime publike të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme. Ky raport ka për qëllim të identifikoj disa arsye se pse po ndodhin këto degradime dhe lëshime në ruajtjen e historisë tonë vizuale.

GJETJET KRYESORE

- Komuna kishte shpall tenderin përkundër që ky investim nuk ishte në ligjin e buxhetit të Kosovës për vitin 2018
- Tenderi i shpallur nuk ishte i definuar as në planifikimin e prokurimit të kësaj Komune për vitin 2018.
- Komuna kishte shkelur nenin 65, paragrafi 3 i ligjit për prokurimin publik duke kërkuar që OE tenderues të dëshmojnë përshtatshmërinë duke kërkuar në mënyrë eksplicite vetëm dëshminë nga Gjykata Themelore Departamenti për çështje ekonomike se ato nuk ishin në proces të falimentimit, por jo edhe dëshminë nga Gjykata Themelore Departamenti i Përgjithshëm se ato, apo ndonjë udhëheqës i tyre, nuk ishin të dënuar për vepra penale¹.

¹ Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

- Komuna kishte shkelur ligjin për trashëgiminë kulturore² duke mos kërkuar që OE tenderues të jenë të certifikuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për këtë fushë veprimtari, duke shpërblyer kështu me kontratë një kompani që aktivitet primar të biznesit ka demolimin e objekteve.
- Komuna nuk kishte cekur në kushtet e veçanta të kontratës se inspektimi i punimeve do të bëhej nga inspektor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ashtu siç kërkohet me ligj³.

METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur nga grupi monitorues në këtë raport bazohet në metodologjinë e kombinuar të monitorimit të aktivitetit të prokurimit me ç’rast përzgjedhja e tenderit për monitorim është bazuar në fushën e ekspertizës me të cilën merret organizata. Sa i përket metodologjisë së hulumtimit të këtij raporti ajo është bazuar në analizen e të dhënave primare të nxjerra lidhur me procesin e tenderimit dhe dhënies së kontratës duke i krahasuar të dhënat me dispozitat nga ligji për prokurim publik dhe ligjeve përkatëse për konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

ANALIZA E KONTRATËS

Në vitin 2018⁴, Komuna e Prizrenit kishte shpallur tenderin⁵ për restaurimin e ndërtesës së ish-armatës, e ndërtuar në vitin 1930, ku në vlerën e parashikuar prej 50,000.00 Euro, ishte kërkuar të krijohej qasja kryesore në përdhese nga një anë, ku do të ishte e dukshme edhe nga ana e rrugës, si dhe një qasje tjetër në objekt. Në përdhese kërkohet të organizoheshin para hyrja/erëmbrojtësi, korridori, hapësira për zyre dhe tualetet. Kjo kontratë ishte përshkruar si ‘Restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në Prizren’, megjithatë, në planin e prokurimit të kësaj Komune për vitin 2018, nuk ishte paraparë restaurimi i këtij objekti⁶.

Ky investim nuk ishte i listuar as në Ligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018⁷.

Tenderi ishte i hapur për 40 ditë, dhe në përgjigje të tij Komuna kishte pranuar shtatë oferta si në vijim:

#	Ofertuesi	Vlera e tenderit EURO
1	N.N. ‘Injineri MSH’, Rr. Shtjefën Gjeqovi nr 77, 20000, Prizren	29,776.63
2	Grup i Operatorëve Ekonomik: NNSH EMSA; NNP CONTRUMAX, Rr. Hasan Prishtina, 23000, Suharekë	30,307.08

² LIGJI NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE, RREGULLORE Nr. 03/2008 MBI AKTIVITETET KONSERVUESE DHE RESTAURUESE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, dhe RREGULLORE (MKRS) NR. 06/2017 PËR CAKTIMIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, VARTËSE TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT, NË CILËSINË E INSTITUCIONEVE KOMPETENTE

³ Ibid

⁴ Tenderi I shpallur me 05 tetor 2018

⁵ Tenderi me numër të prokurimit: 622-18-7623-5-2-1

⁶ Plani i Prokurimi 2018, Komuna e Prizrenit, e qasshme në <https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2018/09/Planifikimi-i-Prokurimit-2018.xls>

⁷ LIGJI Nr. 06/L-020 PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2018, I qasshëm në <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

3	N.N. 'Krasniqi', Xhevat Berisha, PRIZREN	34,942.89
4	'Euro Project', SH.P.K., Abaz Thaqi Nr. 6, 41000, SKENDERAJ	37,111.76
5	NPN 'ALFA-ING', Pellazgët 18A, 20000, Prizren	37,888.20
6	'ALBOSS' SH.P.K., Grejkoc, Suhareke, 23000, GREJKOVC	39,781.09
7	'ALBI COMPANY' SH.P.K, Sylejman Vokshi pn, RAHOVEC	40,625.00

Tabela 1.0 Lista e ofertave në bazë të vlerës monetare

Në bazë të vlerësimit të ofertave, Komuna kishte konkluduar se gjashtë oferta ishin të përgjegjshme, dhe vetëm oferta e N.N. 'Krasniqi' nuk plotësonte kriteret e dëshmimit të kapacitetit ekonomik dhe financiar, dhe atij teknik dhe profesional⁸.

Pas këtij vlerësimi, Komuna kishte vendosur të shpërblente me kontratë ofertën më të lirë, atë të N.N. 'Injering MSH', rruga Shtjefën Gjeqovi Nr. 77, 20000, Prizren në vlerë prej 29,776.63€.

Ndaj këtij vendimi ishte ankuar OE me ofertën më të shtrenjtë 'ALBI COMPANY' SH.P.K, Sylejman Vokshi pn, RAHOVEC, nën pretendimin se AK nuk i kishte dhënë qasje në dokumentet e kërkuara, por pas 1 dite, ndonëse kishte parashtruar kërkesën për qasje në ditë të premtë. AK, kishte refuzuar ankesën e këtij OE, dhe kishte vazhduar me njoftimin për dhënie të kontratës.

Meqë ndaj këtij njoftimi për dhënie të kontratës nuk kishte pasur ankesa në OSHP, Komuna kishte vazhduar me nënshkrimin e kontratës⁹.

Ndonëse në shikim të parë duket se gjatë këtij tenderi gjithçka kishte vajtur siç duhet, analiza na shpërfaq disa probleme lidhur me dosjen e tenderit.

Në kërkesat e përshtatshmërisë, Komuna në mënyrë eksplicite kishte kërkuar dëshmi vetëm nga Gjykata Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike që kompania nuk ishte në proces të falimentimit, duke shkelur kështu ligjin e prokurimit publik¹⁰, respektivisht nenin 65.3. i cili kërkon edhe dëshminë nga Gjykata se kompania apo ndonjë udhëheqës i saj nuk është i dënuar për vepra penale.

Poashtu, ndonëse një kërkesë e obligueshme ligjore¹¹, në dosje të tenderit nuk ishte kërkuar që kompanitë tenderuese të ishin të certifikuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, duke shkelur kështu ligjin bazë që rregullon fushën e konservimit të këtyre objekteve dhe duke rrezikuar humbjen e vlerave të trashëgimisë që posedon ndërtesa. Po ashtu, në

⁸ Nofitim për vendimin e autoritetit kontraktues 13.11.2018, I qasshëm në https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=308958

⁹ Kontrata e nënshkruar me datën 06.12.2018, e qasshme në https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=308958

¹⁰ Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

¹¹ LIGJI NR. 02/L-88 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE, RREGULLORE Nr. 03/2008 MBI AKTIVITETET KONSERVUESE DHE RESTAURUESE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, dhe RREGULLORE (MKRS) NR. 06/2017 PËR CAKTIMIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, VARTËSE TË MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT, NË CILËSINË E INSTITUCIONEVE KOMPETENTE

kushtet e veçanta të kontratës nuk ishte cekur se Ministria përkatëse do të bënte inspektimin e punëve, ashtu siç obligohet me ligjin në fjalë¹².

Për më shumë, kompania e shpërblyer me këtë kontratë, sipas të dhënave nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, jo që nuk ka të deklaruar në fushë-veprimtarinë e aktiviteteve ekonomike¹³ të saj restaurimin dhe konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, por aktivitet kryesor të biznesit ka të regjistruar demolimin e objekteve¹⁴. Sipas po të njëjtit regjistër, asnjëra nga kompanitë tenderuese në fakt nuk kishte të regjistruar restaurimin dhe konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si aktivitet primar të tyre, ndonëse ato ishin shpallur të përgjegjshme, e që është edhe në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, ku sipas nenit 8, OE janë të obliguar të respektojnë të gjitha ligjet në fuqi¹⁵.

KONKLUZION

Analiza e kontratës dhe tenderit në fjalë shpërfaq disa brenga lidhur me investimet në trashëgiminë kulturore. Ndonëse këto objekte janë të një rëndësie të veçantë si për nga aspekti historik, po ashtu edhe nga ai shoqëror e ekonomik, ato nuk po marrin trajtimin e duhur nga institucionet e tona.

Gjatë analizës së këtij tenderi shohim se Komuna e Prizrenit nuk kishte përfillur aspak dispozitat ligjore të ligjit bazë i cili rregullon çështjen e mirëmbajtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore. Mosrespektimi i ligjit që rregullon këtë fushë veprimtari, përveç që kishte shkaktuar një shkelje të kushteve të përgjithshme të kontratës¹⁶ por kishte rezultuar që komuna të rrezikonte performancën e kontratës dhe konservimin e objektit sipas kriterëve më të larta duke shpërblyer me kontratë një kompani e cila jo që nuk ishte e certifikuar për kryerjen e këtyre punëve, por aktivitet kryesor të biznesit kishte demolimin dhe jo riparimin e objekteve.

Pothuajse i njëjti problem ishte identifikuar edhe një vit më parë¹⁷ gjatë analizimit të një tenderi¹⁸ të ngjashëm, ku si përfundim njëri nga objektet e restauruara kishte përfunduar në shpërfytyrim të tërësishëm.

Këto gjetje ngrisin shqetësime lidhur me kapacitetet e komunës dhe njohuritë e tyre lidhur me detyrimet kontraktuale¹⁹. Ndonëse ligji për prokurimin publik rregullon procedurat e sigurimit të një procesi të drejtë

¹² Ibid

¹³ Aktiviteti ekonomik është i definuar me politika mikroekonomike, ndërsa ushtrimin e tyre e adreson Ligji Nr. 2004/ 18 (I plotësuar dhe ndryshuar nga Ligji Nr. 04/L-005) për tregti të brendshme, ku sipas Pjesës 2 të këtij ligji, Ushtrimi i Aktivitetit Tregtar, Neni 6 “Tregtari mund të ushtrojë të gjitha llojet e veprimtarisë tregtare për të për të cilat është i regjistruar, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligjet apo dispozitat e tjera të aplikueshme”.

¹⁴ Kodet më të përafërta të aktiviteteve ekonomike për punën në fjalë janë 9103 Funksionimi i vendeve dhe ndërtesave historike, si dhe i atraksioneve të ngjashme për vizitorë, apo edhe 4120 Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore

¹⁵ Kontrata nr. 622-18-121-521, Kushtet e Përgjithshme të kontratë, Neni 8, Obligimet e Kontraktuesit, paragrafi 8.2. 8.2 “Kontraktuesi duhet t’i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t’i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.”

¹⁶ Neni 8, Përgjegjësitë e OE

¹⁷ “FASADIMI, KONSERVIMI DHE REVITALIZIMI I SHTËPIVE TË VJETRA NË PRIZREN”, EC ma ndryshe, gusht 2020

¹⁸ Tenderi me numër të prokurimit 622-19-7638-5-2-1

¹⁹ LIGJI NR. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, Neni 124

dhe suksesshëm të një prokurimi, janë ligjet të ndryshme në fuqi të cilat sigurojnë që një prokurim publik të arrij qëllimin e tij të efikasitetit dhe economicitetit të tij, ashtu siç edhe kërkohet nga kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligji për prokurimin publik.

Në rastin konkret, analiza tregon se një prokurim publik ishte bërë arsye e shkeljes së një ligji bazë që rregullon fushë veprimtarinë e lëndës së prokurimit.

Analiza po ashtu kishte gjetur se tenderi në fjalë nuk ishte në buxhetin e Kosovës për vitin 2018 dhe as në planifikimin e prokurimit publik për po të njëjtin vit.

REKOMANDIME

- Komuna duhet të siguroj mekanizmat për respektimin e ligjeve të Kosovës gjatë zhvillimit të prokurimeve publike, në rastin konkret zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit për trashëgiminë kulturore.
- Tek kriteret e përshtatshmërisë profesionale, Komuna duhet të përfshijë dispozitat nga Ligji për trashëgiminë kulturore, të cilat definojnë prezantimin e dëshmive të OE për eksperiencat apo licencimet për revitalizimin dhe konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore.
- Komuna duhet të siguroj që vlerësimi i tenderueseve është përmbajtjesor gjatë vlerësimit të përgjegjshmërisë së tyre, e me një theks të veçantë në përshtatshmërinë profesionale.
- Komuna duhet të siguroj se hyrja në detyrime kontraktuale, respektivisht financiare, është në harmoni me ligjin për buxhetin dhe në përputhshmëri me afatet dhe vlerat e planifikimit të prokurimit.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit duhet të rrisë angazhimin në edukimin e autoriteteve kontraktuese lidhur me detyrimet ligjore lidhur me restaurimin dhe konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe të krijoj marrëdhënie pozitive me autoritetet kontraktuese lidhur me nevojat dhe inspektimet e këtyre investimeve në nivel lokal.
- Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet në krijimin e mekanizmave edukues dhe llogaridhënës të cilat detyrojnë autoritetet kontraktuese të respektojnë dispozitat ligjore të ligjeve përkatëse që rregullojnë fushë veprimtaritë e prokurimeve publike.